



VENDIM

Nr.116 Datë 28.12.2010

**PËR
RINOVIMIN E LICENSËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “FAVINA” 1 SH.P.K ME SERI PV05V,
NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE
TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1 gërma “a” të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 13 dhe 16 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /te pjesshem dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Fvina 1” sh.p.k., për rinovimin e liçensës Nr.29, Seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit sic kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”

Vendosi:

1. Rinovimin e liçensës Nr.29, Seria PV05P, të shoqërisë “Favina 1” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.